

**RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS  
(Ligji nr.10.440, shtojca II, Pika 10/b)**

***Objekti :“ NDËRTIMI I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE IBRAHIM HIMA”***



**U hartua nga Specialist i Licencuar:  
TAULANT SHPK  
Ing.Erjona Qatipi  
Nr.Certifikate 5012 dt.04/07/2013  
2022**

## PERMBAJTJA E RAPORTIT TE VNM-SE SE PARAPRAKE

- Përshkrim i legjislacionit në fuqi
- Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis duke përfshirë distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të
- Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes
- Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e projektit dhe në afërsi të tij
- Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër si dhe në përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara
- Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin
- Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

## HYRJE

Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet direkte të projektit tek njerezit, flora dhe fauna, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klimën, terrenin dhe ndërtimi tij si dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve me trashëgimime kulturore, sociale dhe mjedisore. Kjo temë është bazuar në parimet e veprimeve të parandalimit, dhe si e tillë politika më e mirë konsiston në mënjanimin e ndotjes dhe problemeve të tjera që janë ngritur.

Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e vendit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zones. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të perfituara rishtas mbi kushtet e vendit, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim -marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

Bashkia e Tiranës, kërkon të realizojë projektin kërkon të realizojë projektin e zbatimit (studim projektimit) për objektin: “NDËRTIMI I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE IBRAHIM HIMA”

## ➤ INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

### **OBJEKTIVAT AFATSHKURTER TE VNM JANE**

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

### **OBJEKTIVAT AFATSHKURTER TE VNM JANE**

1. Përmirësim nga pikëpamja mjedisore të projektit të propozuar;
2. Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
3. Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
4. Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
5. Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
6. Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
7. Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.

8. Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
9. Të japë informacion mbi vendndodhjen e impiantit dhe të analizojë tiparet mjedisore
10. Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
11. Siguron që është parashikuar alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
12. Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjive se propozuar për tu aplikuar.

#### **Objektivat afatgjatë të VNM janë:**

- ❖ Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- ❖ Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- ❖ Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit;
- ❖ Ndhmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

#### **Pershkrim i metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VNM-së.**

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- ❖ Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;
- ❖ Njohja me infrastrukturën ekzistuese të objektit ku kruhet aktiviteti;
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- ❖ Historiku i ndërveprimit mjedisor;

## **PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT NË FUQI**

Seksioni i mëposhtëm i këtij raporti paraqet në mënyrë përmbledhese ligjet dhe normat përkatëse që janë marrë në konsideratë.

Miruar në vitin 1998, Kushtetuta e Shqipërisë përcakton kornizën e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe miraton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe të drejtën e publikut për lirinë e informacionit mbi mjedisin.

Kuadri ligjor vendor Legjislacioni mjedisor është ndertuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit. Kështu, ndër me specifiket mund të përmendim:

Kështu, ndër me specifiket mund të përmendim:

Ligjin Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"

Ligji Nr.10 440, date 7.7. 2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit"

Ligji Nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Vendim Nr. 177, date 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit"

ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”  
Ligji Nr.9587, date 20.07.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit"  
Ligji Nr.10 081, date 23.02.2009 "Per Licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".  
VKM Nr. 686, date 29.07.2015, “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore”.  
Vendim i KM Nr.1189, Date 18.11.2009 "Per Rregullat Dhe Procedurat Per Hartimin Dhe Zbatimin e Programit Kombetar Te Monitorimit Te Mjedisit"  
Vendimi i KM Nr. 805, dt 04.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore".  
VKM-së nr. 435 datë 12.09.2015 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.  
Vendimi i KM Nr.247, date 30.04.2014 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin".  
Vendim i KM Nr. 123, date 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"  
Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"  
Vendim i KM Nr. 99, date 18.2.2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve"  
Vendim i KM Nr. 177, date 31.3.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisive ujore pritese"  
Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"  
Vendim i KM Nr. 16, date 14.01.2012 "Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor"  
Vendim Nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror"  
VKM Nr. 575, date 24.06.2015, “Per menaxhimin e mbetjeve inerte”  
Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne republiken e shqiperise. Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:  
Ligji Nr. 9672 date 26.10.2000: "Per ratifikimin e konventes se Aarhusit" Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimmarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.  
Ligji Nr. 9334 date 16.12.2004: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos" ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).  
Ligji Nr. 9424 date 06.10.2005: "Per ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor".  
Ligji Nr. 9486 date 06.03.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit" Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.  
Ligji Nr. 9548 date 01.06.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve"

Hartimi i kesaj VNM -je dhe zbatimi i ketij projekti është i mbikqyrur nga disa institucionet qëndrore dhe ato lokale për zbatimin me rigoroz të të gjitha ligjeve dhe normave të parashtuara në ligjet përkatëse sipas institucioneve dhe kopentecave te tyre.

Hartimi i këtij raporti vnm është bërë në përputhje me ligjin nr. 10 440, datë 07.07.2011, ”për vlerësimin e ndikimit në mjedis“, ku sipas shtojcave të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedures se vlerësimit të ndikimit në mjedis, dhe projekti në fjale i nënshtrohen procedures paraprake

të vlerësimit të ndikimit në mjedis **Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukturore b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat.**

## KUADRI LIGJOR NDERKOMBETAR

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- ✚ Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- ✚ Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- ✚ Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- ✚ Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) ”Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- ✚ Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- ✚ Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- ✚ Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- ✚ Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- ✚ Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujerave të embla
- ✚ Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.

### ➤ PERSHKRIMI I PROJEKTIT

**Projekti:** Njësia Administrative Vaqarr, Fshati Prush, në qytetin e Tiranës.

**Vendndodhja:** Shkolla 9 vjecare “Ibrahim Hima” ndodhet në territorin e mbuluar nga Njësia Administrative Vaqarr, Në rrugën lidhëse midis Fshatrave Prush dhe Gropaj. Objekti ekzistues është 1 (një) kat me strukturë mbajtëse me mure me një numër total prej 10 klasash, që janë në funksion të rreth 200 nxenesve. Sipërfaqja totale e ndërtimit ndërtimit është 480 m<sup>2</sup>, 435 m<sup>2</sup> për objektin e shkollës dhe 45 m<sup>2</sup> për dy objekte me funksion nyjesh sanitare dhe magazine. Shkolla shtrihet në një truall me sipërfaqe 1300 m<sup>2</sup> të rëluar me gjeresi që varion nga 23 në 27 m dhe gjatesi 59 m.


*Plani i vendosjes*

*Planvedosje*





VENDODHJA E OBJEKTIT




**Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit GAUS GRUGER**


Nr.	E	N
1	4394503.25	4577208.32
2	4394522.71	4577171.69
3	4394531.50	4577180.55
4	4394537.86	4577198.12

**Tabela Nr.2. Kordinatat e zones sipas sistemit KRGJSH**

Nr.	E	N
1	478098.35	4576342.19
2	478118.23	4576305.79
3	478126.91	4576314.75
4	478133.07	4576332.39


**Plani i Katit Perdhe**

Plan Mobilimi Kati Pare



Plani i Katit te Pare

Plan Mobilimi Kati Dyte



Plani i Katit te Dyte

*Pamje 3dimensionale te objektit*





### Pershkrimi i objektit dhe i struktures

Shkolla eshte menduar si qender komuniteti, dhe per kete ambientet qe kane frekuence me te madhe jane vendosur ne katin perdhe te godines, duke mundesur edhe aksesin me te lehte te personave me aftesi te kufizuar. Kjo shkolle ndodhet ne nje mjedis rural. Siperfaqja ekzistuese e territorit te shkolles sipas gardhit kufizues eshte 1725 m<sup>2</sup> ndersa njolla e objektit ekzistues eshte 435 m<sup>2</sup>. Prona e kufizuar nga shkolla eshte ne forme L, dhe vetem nje siperfaqe prej 1530 m<sup>2</sup> ofron kushtet e nevojshme per tu zhvilluar. Brenda kesaj pjese te prones arrihet te plotesohen te gjitha kriteret funksionale te objektit te shkolles, por lene te kufizuara ambientet perreth saj duke i limituar ato vetem ne pjesen veriperndimore te truallit. Pa dhene mundesine e krijimit te ambienteve te tjera sportive perkrah ambientit te mbuluar te palestres. Siperfaqja e limituar e oborrit do te shtohet me pllaka decorative dhe me lulishte te mbjella me peme, lule e bar, stola. Per plotesimet e kerkesave qe shkolla te jete qender komunitet dhe hapësirave me te medha te gjelberta eshte e nevojshme zgjerimi i kufirit perendimor me 20 m. Plani propozuar mundeson edhe ndertimin e nje fushe te jashtme per aktivitetet sportive, krahas palestres. Siperfaqe totale e parashikuar per shpronosim eshte 900 m<sup>2</sup>. Brenda kufirit te parashikuar te prones do te perfshihet: Objekti i ri i shkolles sebashku me palestren dhe sallen polifunkionale, si dhe ambiente te dedikuara per parashkollorin dhe ambientet teknike te shkolles. Arkitektura e shkolles cilesohet funksionale dhe duke perdorur si element dekorativ te fasades hijezuesit shumengjyresh, prej alukobondi, te vendosura verkalish ne anen jugore te dritareve te vendosura ne fasadat lindore dhe perendimore. Keta hijezues krahas elementit dekorativ kane per dyre te ndalojne rrezet e uleta te diellit gjate lindjes dhe perendimit te tij.

**Të dhëna mbi sipërfaqet:**

-Siperfaqe e truallit	1 725 +900 m <sup>2</sup>
-Siperfaqe e katit perdhe (Godina Shkolles)	1038 m <sup>2</sup>
-Siperfaqe e katit te pare (Godina Shkolles)	717 m <sup>2</sup>
-Siperfaqe e katit te dyte (Godina Shkolles)	520 m <sup>2</sup>
-Koeficienti i shfrytezimit te territorit	0.39
-Siperfaqe totale	2275 m <sup>2</sup>
-Intensiteti i ndertimit	0.87
-Lartesia e pergjithshme mbi toke	11.5 m

**Shtresat e dysHEMEVE**

Dyshemete e shkolles do te trajtohen sipas funksioneve dhe ngarkeses ne to. Ne hapesirat e dedikuara per ambientet e mesimdhënies dyshemete do jene me pllaka gres porcelanato, format 60x60 cm ose I ngjashem. Koridoret dhe ambientet e aksesit do te shtrohen me pllaka gres porcelanato 30x60cm. Ndersa dysHEMEJA e ambienteve parashkollore dhe palestra do te jene me parket druri per konfort sa me te mire per perdoruesit. Nyjet sanitare per te mundesuar sa me mire krijimin e pjerresive rekomandohet te shtrohen me pllaka gres porcelanato 40x40cm. Ne katin perdhe eshte parashikuar ne dysHEME nje shtrese hidroizoluese per mbrojtjen e objektit nga ujerat nentokesore si edhe nje shtrese termoizoluese e realizuar me ane te panele me zgaver ajri (Igloo ose i ngjashem). Trotuari perreth godines do te jete me pllaka betoni te vendosura mbi shtrat rere, per te mundesuar drenimin e ujrave. Fushat sportive do jene me beton te ilustruar me ngjyre dhe kuarc.

**Shkallet.**

Shkallet e objektit do te parashikohen me bazamake mermeri te nxjerre nga kavat locale. Planvendosja e katit perdhe ne kuote te njejte me oborrin (+2 cm) mundeson aksesin e plote edhe nga perdoruesit me aftesi motorike te kufizuar. Kangjellat e shkalleve do te jene me profile hekuri sipas detajit arkitektonik, me profile cdo 11 cm dhe me lartesi 1.0 m. Ne objekt parashikohet te vendoset edhe shkallet e emergjences, shkalle te jashtme metalike, qe do i sherbejne te gjithe kateve.

**Dyer, dritare.**

Dyert do te jene tamburato material MDF, me kase druri. Ato propozohet te hapen nga jashte, ne rast evakuimi, qe lejon hapjen e dyerve nga jashte pa cenuar levizjen e lire ne koridore. Dyert kryesore dhe ato te emergjences do te jene durale me doppio xham. Dritaret propozohen Plastike PVC me xhama doppio termik, duke siguruar izolim termik dhe akustik te objektit. Hapja e tyre do te jete me sopraluç.

**Ambientet sanitare**

Ambjentet sanitare jane propozuar ne qender te korridorit per per nje akses sa me te mire nga te gjithe nxenesit. Ndersa nyjet sanitare dhe garderobat per palestren jane vendosur perkrah ketij ambienti. Secili kat esht i pajisur me nyje sanitare per PAK.

**Rifinitura e mureve**

Pergjate mureve te klasave, ne lartesine e karrikeve jane perdorur shirita me dru te perpunueshem, me gjeresi 15 cm per te mos u demtuar suvaja. Pjesa e poshtme e mureve do te lyhet me boje vaji per t'u pastruar me lehte. Muret e koridove do te lyhen me boje plastike ne gjithe lartesine e tyre per te mundesuar pastrimin dhe konservimin e tonalitetit te bojes. Qoshet e kolonave do te kene profile alumini ne forme "L" per t'i mbrojtur nga demtimet. Pllakat e shtrimit do te jene gres porcelan.

### **Tavanet**

Tavanet jane paraashikuar te jene te varura me gips. Ne ambientet e koridoreve dhe klasave do te vendosen tavanet 60x60 cm me nje fasho gips lisho perreth konfigurimit. Tavanet e nyjeve sanitare dote jene te gjithë me tavan lisho. Ne ambintet teknike parashikohet aplikimi i suvase.

### **Fasadat**

Ne lidhje me fasadat propozohet termoizolim i tyre me EPS  $t=8\text{cm}$ , rrjete fiber xhami dhe suvatim garfiato. Kjo do te permiresoje izolimin termik ne ambjentet e brendshme dhe ruajtjen e energjise. Gjithashtu do te perdoren elemente alukobondi me ngjyra te ndryshme sipas vizatimeve qe se bashku me dekorimin e fasades do ti sherbejme edhe hijezimin e dritareve nga rrezet e uleta te diellit.

### **Taraca**

Taraca ne ambientet e shkolles, pervec palestres do te jete me strukture betonarmeje. Çatia e palestres do te jete me panele sanduic me pjerresi minimale brenda kushteve teknike. Taraca e objektit do te jete e termoizoluar dhe hidroizoluar.

## **PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES BIMORE KUPROPOZOHET TE NDERTOHEH PROJেকTI DHE FOTOGRAFITE PERKATESE FLORA**

Bimesia e zones dominohet nga bime te kultivuara, si drithera, perime, peme frutore, vreshta, etj. Nga pikepamja floristike, zona ben pjese ne zonen e shkurreve mesdhetare, te cilat jane te veshtira per t'u kultivuar, pasi ato gjate viteve jane zevendesuar me kulturat bujqesore.

### **FAUNA**

Persa i takon botes shtazore, zona ne fjale nuk dallohet per ndonje bote te tille te pasur. Per zonen nuk zoterohet ndonje material i bollshem dhe i hollesishem lidhur me faunen, por prania e kafsheve te egra eshte e rralle dhe ne pergjithesi vihen re vetem kafshe ose shpende shtepiake.

Zogjte qe gjenden ne zone jane pellumbi (*Streptopelia decaoto*), trumcaku (*Troglodytes*), harapela (*Passer domesticus*). Insektet perfaqesohen nga brumbuj, grenxa, milingona, flutura, pilivesa, etj. Kjo per vete kushtet e relievit te cilat nuk favorizojne mbareshtimin e faunes se eger te cilat nuk gjejne kushte te favorshme ekologjike.

Disa specie te vezhguara jane:

#### **Gjitaret:**

Lutra lutra (vidra e zakonshme)

Plecotur auritus (lakuriqi veshgjate)

Nyctalus noctula (lakuriqi i nates)

Zogjte:

Hippolais olivetorum (cafka e ullirit)

Sylvia nisoria (cafke)

Zvarraniket

*Emys orbicularis* (breshke e mocalit)

*Mauremys caspica* (breshke e mocalit)

*Testudo hermanni* (breshka mesdhetare e tokes)

*Lacerta trilineata* (hardhuce e gjelber me tre vija)

*Lacerta viridis* (hardhuce e gjelber)

*Podarcis taurica* (hardhuca)

Amfibet:

*Rana lessonae* (bretkose e vogel e ujit)

*Hyla arborea*

*Triturus cristatus* (Salamandra)


*Bufo viridis* (bretkosa e gjelber)

Prane segmentit nuk ndodhen specie me status te rrezikuar, si per floren ashtu dhe per faunen.

#### a) Informacion per pranine e burimeve ujore ne sipërfaqen e zene nga projekti dhe ne afersi te tij.

Terreni i kesaj zone eshte fushore. Nga lindja dhe verilindja ndodhet nje sistem kodrinor i bute me lartesi deri ne 80 m deri ne 450 m lartesi nga niveli i detit i kultivuar me foragjere, peme frutore (vecanerisht me ullinj dhe vreshta) si dhe me shkurre mesdhetare me nje bimesi mesatare. Terreni eshte i larmishem bujqesor, i fragmentizuar, me bime bujqesore (foragjere dhe drithera) si dhe me plantacione te kufizuara mollesh, pjeshkesh dhe sera diellore

Per sa i perket projektit qe do te ndertoht nuk vecohet per ndonje peisazh tevecante. Kjo zone ka nje peisazh te thjeshte pa ndonje vecori. Ne kete sipërfaqe ka ndertesa ekzistuese, eshte nje zone ku objektet e banimit ndodhen ne distanca te aferta nga objekti me densitet te larte.





**b) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet ne biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.**

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të perberësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

**Mbrojtja e perberësve të mjedisit klasifikohet në:**

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujerave
- ❖ Mbrojtja e tokës
- ❖ Mbrojtja e natyrës
- ❖ Ndryshimet klimatike

Ky ndertim do të kryhet mbi një sipërfaqe tokë të lirë nga ndertimet e cila nuk përdoret, nuk ka bimësi të lartë, nuk ka park natyror, nuk ka demtime të bimesisë së zonës.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- ❖ Në fazën e ndërtimit.
- ❖ Në fazën e funksionimit.

Rendesi ka të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte apo indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen në tokë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- ❖ Ndikime të kthyeshme në mjedis
- ❖ Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

## **Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:**

- ❖ Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij.
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes.
- ❖ Konsultimi me dokumenta ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM-së për veprimtari të njëjta.
- ❖ Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuar.

Ndikimet kryesore në mjedis nga ndertimi dhe funksionimi i kesaj rruge konsistojne në vija të përgjithshme si më poshte:

- ❖ Emetimet në ajër dhe zhurmat
- ❖ Shkarkimet në ujë
- ❖ Ndikimi në tokë
- ❖ Ndikimi në florë/faunë
- ❖ Mbetjet e prodhuara
- ❖ Ndikime social-ekonomike
- ❖ Ndikim në cilësinë e jetës në qendrat e banuara
- ❖ Ndikim në rritjen e trafikut rrugor
- ❖ Ndikim në peizazhin e zonës
- ❖ Ndikim në ndryshimet klimatike

Ndikimet mjedisore e sociale të projektit janë konsideruar në dy fazat e tij; atë të ndertimit dhe të funksionimit. Nëse faza e ndertimit ka një qartësi kohezgjatëse, ajo e operimit dhe/apo e mbylljes janë krejtësisht të varura nga mirëmbajtja e objekteve.

### **ç) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.**

Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis:

1. Shkarkimet në mjedis nga zbatimi i këtij projekti, në terma të shkurtuara do të ishte: Shkarkime në ajër nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturore të kantierit të ndertimit, gazet e mjeteve të ndertimit dhe të transportit.
2. Shkarkime në ujëra nga ujerat e shiut nga kantieri dhe ujerat e zeza nga aktiviteti gjatë shfrytëzimit.
3. Shkarkimet e mbetjeve të ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu që do të largohet nga sipërfaqja që do të ndertohej.
4. Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e rënda, nga transporti, por edhe gjatë funksionimit nga aktivitetet me muzikë në orë të vona, nëse do të zhvillohen.

## **Emetimet në ajër**

Emetimet në ajër vijnë nga perhapja e pluhurave të materialeve të ndertimit dhe materialit të germuar të sipërfaqes së tokës. Gjithashtu djegia e lëndës djegëse, që shkaktohet nga automjetet që frekuentojnë këto ambiente, si dhe në rastet kur ka mungesë të energjisë elektrike dhe do të lindë nevojë për ndezjen e gjeneratorit.

Nga punimet ndertuese do te kete perhapje te pluhurave nga qarkullimi i mjeteve.

Perdorimi i reres, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit te siperfaqeve perreth, si dhe nga transporti i automjeteve te dheut te germuar apo te mbetjeve inerte te prodhuara gjate ndertimit. Keto mjete duhet te plotesojne patjeter kushtet teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar, te mbulohet karrocera me mushama te posacme, si dhe te lahen rregullisht kur dalin nga kantieri i ndertimit dhe nga kantieri i prodhimit te betonit, te inerteve apo ne sheshin e depozitimit te dheut te germuar.

## Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti i rikualifikimit te zones jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se kantierit, larjes se gomave te automjeteve dhe ujerat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varesi edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhoje mund te jete i nevojshem grumbullimi i ketyre ujerave dhe orientimi i tyre ne sistemin e kanalizimeve, pjeserisht ato filtrojne nentoke.

## Zhurmat dhe vibrimet

